

1 E enjte, 2 shkurt 2023

2 [Aktgjykim i Apelit]

3 [Seancë e hapur]

4 [Apeluesit hyjnë në sallën e gjyqit]

5 --- Seanca fillon në orën 14.00

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Ndërkohë  
7 presim një minutë e gjysëm që të bëhen fotografitë.

8 Faleminderit, znj. Fotografe.

9 Mirëdita. Mirë se erdhët.

10 Znj. Sekretare e Gjykatës, ju lutem paraqisni lëndën.

11 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Përshëndetje. Kjo është  
12 çështja KSC-BC-2020-07 [sipas përkthimit], Prokuroria e  
13 Specializuar kundër Hysni Gucati dhe Nasim Haradinajt.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]

15 Faleminderit, Sekretare e Gjykatës.

16 Për procesverbal shënoj që z. Gucati dhe z. Haradinaj  
17 janë të pranishëm në sallën e gjyqit, do ju lutesha palëve të  
18 prezantohen, duke filluar me mbrojtësin e z. Gucati.

19 Z. REES: [Përkthim] Jam në emër të z. Gucati këtu. Dhe më  
20 ndihmon bashkëndihmësi z. Bowden dhe Z. Stephenson, gjithashtu  
21 z. Dashi, z. Halilaj dhe z. Stephen Clarke.

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Mbrojtësi i  
23 z. Haradinaj.

24 Z. CADMAN: [Përkthim] Mirëdita. Jam këtu në emër të z.  
25 Haradinaj. Dhe më ndihmon znjsh. Bernabeu, z. Soliman, z.

1 Berisha.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Dhe  
3 Prokuroria e Specializuar, ju lutem.

4 Z. HALLING: [Përkthim] Mirëdita. Për ZPS-në këtu, kemi  
5 Ward Ferdinandusse, James Pace, Line Pederson dhe Matt  
6 Halling.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim]  
8 Faleminderit.

9 I drejtohem Zyrës Administrative tashmë.

10 ADMINISTRATORJA:: [Përkthim] Mirëdita. Fidelma Donlon,  
11 Administratorja, bashkë me z. Ralph Roche, shefi i Shërbimeve  
12 Administrative.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES PICARD: [Përkthim] Për  
14 procesverbal, unë jam Michele Picard, Kryegjykatësja në këtë  
15 çështje. Në të majtën time është Gjykatësja Nina Jorgensen;  
16 dhe në të djathtë, Gjykatësi Kai Ambos.

17 Gjykata e Apelit do të shqiptojë publikisht aktgjykimin  
18 në emër të popullit të Kosovës dhe në prani të të akuzuarve.

19 Kjo çështje gjyqësore ka të bëjë me apelet kundër  
20 konstatimeve të Trupit Gjykues në lidhje me përgjegjësinë e z.  
21 Gucati, kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës të  
22 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të z. Haradinaj, nënkryetar  
23 i së njëjtës organizatë, në një varg ngjarjesh që u zhvilluan  
24 gjatë një periudhe tre-javore nga 7 shtatori 2020 deri më 25  
25 shtator 2020.

1 Më 18 maj 2022, Trupi Gjykses shqiptoi aktgjykimin me të  
2 cilin shpalli fajtor secilin prej të akuzuarve për vepra  
3 penale kundër rendit publik dhe vepra penale kundër  
4 administrimit të drejtësisë dhe administratës publike. Të  
5 akuzuarit u shpallën fajtorë për pesë pika të aktakuzës, Pikat  
6 1, 2, 3, 5 dhe 6 dhe të pafajshëm për një pikë, Pika 4. Trupi  
7 Gjykses e dënoi secilin të akuzuar me një dënim të njehsuar  
8 prej katër vjet e gjysmë burgim, duke llogaritur kohën e  
9 paraburgimit dhe me një gjobë prej 100 euro.

10 Trupi Gjykses konstatoi se gjatë periudhës së aktakuzës  
11 të akuzuarit morën, nga burime të panjohura, tre grupe  
12 dokumentesh që përmbanin informacion konfidencial dhe jo-  
13 publik që lidhej me punën dhe hetimet e Task Forcës Hetimore  
14 Speciale, e njohur si TFHS dhe të Zyrës së Prokurorit të  
15 Specializuar, të njohur si ZPS.

16 Ky material u dorëzua në zyrat e Organizatës së  
17 Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në 7  
18 shtator 2020, 16 shtator 2020 dhe 22 shtator 2020.

19 Pas çdo dorëzimi, të akuzuarit, thirrën dhe organizuan  
20 konferencë për shtyp, ku diskutuan dhe u vunë në dispozicion  
21 gazetarëve secilin prej grupeve të dokumenteve.

22 Gjatë së njëjtës periudhë, të akuzuarit, individualisht  
23 ose së bashku, dhanë një numër intervistash në media në lidhje  
24 me këtë material. Ata gjithashtu bënë komente për materialin  
25 dhe ripublikuan artikuj në mediat sociale. Ato çka mbetën nga

1 grupet e dokumenteve iu dorëzuan në vijim ZPS-së dhe u  
2 identifikuan si Paketat 1, 2, 3 dhe 4 ose "Paketat".

3 Përpara se të bëj përmbledhjen e konstatimeve të Panelit  
4 në këtë çështje gjyqësore, Paneli dëshiron të theksojë se  
5 Dhomat e Specializuara u krijuan në lidhje me akuzime të rënda  
6 për trajtim çnjerëzor, vrasje të personave dhe krimeve të  
7 tjera të rënda gjatë dhe pas konfliktit të armatosur në  
8 Kosovë. Para themelimit të Dhomave të Specializuara, pengesat  
9 e hasura nga gjykatat dhe tribunalët e tjerë në zbulimin e së  
10 vërtetës për këto ngjarje përbënin një shqetësim të  
11 vazhdueshëm, ku përfshihej ngurrimi ose frika e dëshmitarëve  
12 për të dëshmuar dhe mungesën e besimit të tyre tek masat  
13 mbrojtëse.

14 Paneli rikujton se pikërisht në këtë kontekst u krijuan  
15 Dhomat e Specializuara me qëllim që të garantoheshin procese  
16 penale të sigurta, të pavarura, të paanshme, të drejta dhe  
17 efikase në lidhje me këto pretendime për krime të rënda.

18 Lloji i krimeve që përfshihen në juridiksionin e Dhomave  
19 të Specializuara dhe kontekstin në të cilin u kryen ato, bëjnë  
20 të nevojshme mbështetjen në dëshmitë gojore. Është me rëndësi  
21 themelore për përmbushjen e misionit të Dhomave të  
22 Specializuara që individët të cilët vijnë për të dhënë dëshmi,  
23 shpesh për përvoja traumatike ose të vështira, ta bëjnë këtë  
24 pa pasur frikë. Mbrojtja e dëshmitarëve nga frikësimi dhe  
25 dëmtimi është në themel të çdo sistemi të drejtësisë penale,

1 përfshirë edhe Dhomat e Specializuara. Kjo çështje gjyqësore  
2 ka të bëjë, pra, me administrimin e duhur të drejtësisë,  
3 integritetin dhe sigurinë e procesit dhe sigurinë e  
4 dëshmitarëve.

5 Tani do të lexoj një përmbledhje të konstatimeve kryesore  
6 të Panelit. Kjo përmbledhje nuk është pjesë e aktgjykimit të  
7 apelit dhe as nuk është autoritative. Aktgjykimi me shkrim  
8 është i vetmi dokument autoritativ i konstatimeve të Panelit.

9 Të dy, z. Gucati dhe z. Haradinaj, paraqitën apele me të  
10 cilat kundërshtuan verdiktet e fajësisë për Pikat 1, 2, 3, 5  
11 dhe 6 të aktakuzës, si dhe kundërshtuan një numër konstatimesh  
12 të Trupit Gjykses lidhur me to. Gjithashtu, që të dy  
13 kundërshtuan edhe dënimin e dhënë. Apeli i z. Gucati përmbante  
14 20 arsye për apel me një numër nënpikash dhe apeli i z.  
15 Haradinaj përmbante 24 arsye dhe një numër nënpikash.

16 Në emër të Panelit, së pari do të bëj përmbledhjen e  
17 konstatimeve të Panelit për gabimet e pretenduara lidhur  
18 aspekte të gjykimit të drejtë dhe të provave. Pas kësaj do të  
19 bëj përmbledhjen e konstatimeve të apelit lidhur me apelimin e  
20 Pikave 5, 6, 3, 1, 2 dhe më tej do të trajtoj argumentet  
21 mbrojtëse dhe arsyet për përjashtimin e përgjegjësisë të  
22 paraqitura nga të akuzuarit. Në fund do të trajtoj apelet në  
23 lidhje me dënimin.

24 Në pjesën hyrëse mbi aspekte të gjykimit të drejtë dhe të  
25 provave, Paneli trajton gabimet e pretenduara nga z. Gucati

1 dhe z. Haradinaj në lidhje me vendimet e Trupit Gjykses për të  
2 mos nxjerrë ose për të redaktuar një pjesë të materialeve që  
3 përmbanin Paketat. Paneli konstaton se dokumentet që përmbanin  
4 Paketat nuk janë relevante për përmbajtjen por për natyrën e  
5 tyre konfidenciale.

6 Duke e mbajtur parasysh se dokumentet që përmbanin  
7 paketat ishin pjesë e hetimeve në kryerje e sipër të ZPS-së,  
8 Paneli konstaton se ishte e arsyeshme të urdhërohej që një  
9 hetues i ZPS-së të konfirmonte statusin konfidencial të  
10 dokumenteve si masë kompensuese për mosnxjerrjen e pjesëve të  
11 Paketave.

12 Paneli më tej vëren se Mbrojtja pati mundësinë t'i bënte  
13 pyetje hetueses së ZPS-së, Dëshmitarja W04841 dhe se, krahas  
14 mbështetjes në këtë dëshmi, Trupi Gjykses vërtetoi  
15 autenticitetin dhe natyrën konfidenciale të Paketave duke u  
16 mbështetur në një numër burimesh të tjera. Paneli i Apelit  
17 konstaton se të akuzuarit nuk kanë arritur të provojnë gabim  
18 në konstatimet e Trupit Gjykses.

19 Sa u takon vendimeve të Trupit Gjykses, në seanca ex  
20 parte pa praninë e Mbrojtjes, për materiale që u pretendua se  
21 kishin lidhje me argumentin e shtytjes për kryerje të veprës  
22 penale, Paneli gjykon se procedura e ndjekur nga Trupi Gjykses  
23 gjatë vlerësimit të kërkesës së ZPS-së sipas rregullit 108 të  
24 Rregullores i përmbush standardet e gjykimit të drejtë.  
25 Paneli, rrjedhimisht, rrëzon kundërshtimet e z. Haradinaj.

1 Paneli u kthehet argumenteve të z. Haradinaj se Trupi  
2 Gjykues gaboi që refuzoi të pranonte parashtrime pas mbylljes  
3 së gjykimit në lidhje me pretendimet e ngritura nga z. Dick  
4 Marty. Paneli i Apelit konstaton se z. Haradinaj nuk ka  
5 arritur të provojë gabim në konstatimin e Trupit Gjykues për  
6 mungesën e lidhjes ndërmjet këtij materiali dhe çështjes  
7 gjyqësore aktuale.

8 Kundërshtime të tjera në lidhje me aspekte të gjykimit të  
9 drejtë dhe të provave trajtohen në aktgjykimin e apelit. Unë,  
10 në emër të Panelit, do të trajtoj apelimin e Pikave 5, 6, 3, 1  
11 dhe 2 të aktakuzës.

12 Palët paraqitën argumente të hollësishme në lidhje me  
13 gabimet e pretenduara të Trupit Gjykues sa u takon elementeve  
14 material dhe mendor të veprave penale dhe Paneli do të  
15 përmbledhë konstatimet kryesore.

16 Pika 5 e aktakuzës ka të bëjë me veprën penale të  
17 shkeljes së fshehtësisë së procedurës nëpërmjet zbulimit të  
18 paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në  
19 procedura zyrtare e ndëshkueshme sipas nenit 392, paragrafi 1,  
20 të Kodit Penal të Kosovës. Të akuzuarit kundërshtuan  
21 konstatimet e Trupit Gjykues në lidhje me veprimin e fajshëm  
22 të kësaj vepre penale.

23 Paneli do të fillojë me kundërshtimet e të akuzuarve në  
24 lidhje me konstatimet se informacioni i mbrojtur u zbulua në  
25 mënyrë "të paautorizuar". Z. Gucati parashtroi se nxjerrja e

1 informacionit konfidencial në interesin publik ose prej një  
2 sinjalizuesi lejohet me ligj. Paneli, megjithatë, konstaton se  
3 këto argumente mbrojtëse mund ta përjashtojnë përgjegjësinë  
4 penale por nuk do të ndikonin në veprimin e fajshëm të veprës  
5 penale sipas nenit 392, paragrafi 1, të Kodit Penal të  
6 Kosovës. Këto argumente, rrjedhimisht, nuk janë relevante për  
7 vlerësimin e kundërshtimeve ndaj veprimit të fajshëm të kësaj  
8 vepre penale.

9 Z. Gucati parashtroi se kryesi i veprës penale mund të  
10 jetë vetëm "marrësi i parë i informacionit", që nënkupton ZPS-  
11 në ose homologët e saj. Paneli rrëzon interpretimin e z.  
12 Gucati dhe pajtohet me konstatimin e Trupit Gjykses se neni  
13 392, paragrafi 1, i Kodit Penal të Kosovës nuk kërkon  
14 specifikisht që informacioni duhet të jetë nxjerrë  
15 drejtpërsëdrejti kryesuesit të veprës penale.

16 Sa i përket llojit të informacionit të mbrojtur, Paneli  
17 rikujton se neni 392, paragrafi 1, penalizon dy alternativa:  
18 Së pari, zbulimin e paautorizuar të informacionit i cili sipas  
19 ligjit nuk duhet të zbulohet; dhe, së dyti, zbulimin e  
20 paautorizuar të informacionit që është shpallur si i fshehtë  
21 nga një autoritet kompetent.

22 Paneli ka bërë vlerësimin e argumenteve të të akuzuarve  
23 në lidhje me alternativën e dytë. Sa i takon interpretimit të  
24 termit "fshehtësi", Paneli konstaton se z. Gucati nuk ka  
25 arritur të provojë se Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se



1 informacioni i trajtuar si konfidencial nga ZPS-ja duhet të  
2 konsiderohet si i fshehtë sipas kuptimit të nenit 392,  
3 paragrafi 1, të Kodit Penal të Kosovës. Gjithashtu, në  
4 kundërshtim me pretendimin e z. Gucati, korniza ligjore e  
5 Dhomave të Specializuara nuk përmban asnjë detyrim për ZPS-në  
6 që të vërtetojë se informacioni në fjalë ishte klasifikuar në  
7 mënyrë të ligjshme dhe të drejtë si i fshehtë.

8 Pasi hodhi poshtë kundërshtimet ndaj njërës prej dy  
9 alternativave sipas nenit 392, paragrafi 1, të Kodit Penal të  
10 Kosovës, Paneli nuk i trajtoi kundërshtimet në lidhje me  
11 përmbushjen e kushteve për alternativën tjetër; pra, në lidhje  
12 me atë nëse informacioni i mbrojtur i plotëson kriteret si  
13 informacion "që nuk duhet të zbulohet sipas ligjit".

14 Në përfundim, për këtë pikë, Paneli i Apelit rrëzon  
15 kundërshtimet e Mbrojtjes ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses  
16 për Pikën 5.

17 Në lidhje me Pikën 6, Pika 6 e aktakuzës ka të bëjë me  
18 veprën penale të zbulimit të paautorizuar të identiteteve dhe  
19 të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur, e  
20 ndëshkueshme sipas nenit 392, paragrafi 2, të Kodit Penal të  
21 Kosovës. Të akuzuarit kundërshtuan konstatimet e Trupit  
22 Gjykses në lidhje me veprimin e fajshëm të kësaj vepre penale.

23 Paneli do të fillojë me kundërshtimet e të akuzuarve ndaj  
24 konstatimeve në lidhje me termin "person" në kontekstin e  
25 formulimit "person i mbrojtur në procedura penale".

1 Paneli konstaton se Mbrojtja nuk ka arritur të provojë  
2 gabim në konstatimin e Trupit Gjykues se, në kontekstin e  
3 Pikës 6, termi "person" përfshin dëshmitarët dhe dëshmitarët e  
4 mundshëm sikurse u përkufizua nga hetuesja e ZPS-së,  
5 Dëshmitarja W04841.

6 Paneli do të trajtojë tani kundërshtimet e të akuzuarve  
7 ndaj konstatimeve për pjesën e dytë të formulimit "i mbrojtur  
8 në procedura penale".

9 Z. Gucati argumentoi se Mbrojtja duhet "të miratohet" dhe  
10 jo të nënkuptohet. Të dy të akuzuarit argumentuan më tej se  
11 Trupi Gjykues gjykoi gabim se të gjithë personat e përmendur  
12 me emër në dokumentet e TFHS-së dhe të ZPS-së ishin të  
13 mbrojtur *ipso facto*.

14 Paneli konstaton se formulimi në Kodin Penal të Kosovës,  
15 pra, "i mbrojtur në procedura penale" jo domosdoshmërisht bën  
16 të nevojshme dhënien e një urdhri gjyqësor, por mund të  
17 përfshijë edhe masat mbrojtëse të zbatuara nga ZPS-ja gjatë  
18 hetimeve të saj. Për këto masa nuk është e nevojshme  
19 përmbushja e kriterëve të përmendura nga të akuzuarit, ndër të  
20 cilët urdhri gjyqësor për "miratimin" e mbrojtjes,  
21 identifikimi i secilit prej personave në fjalë ose dhënia e  
22 pëlqimit nga personi për të cilin kërkohen masat mbrojtëse.

23 Paneli gjithashtu mban parasysh, se Pika 6 e aktakuzës,  
24 sipas nenit 392, paragrafi 3, të Kodit Penal të Kosovës,  
25 përfshinë dy forma të rënda të veprës penale bazë. Vetëm njëra

1 formë e rëndë është relevante për këtë çështje gjyqësore, që  
2 është rasti kur vepra penale e nenit 392, paragrafi 2,  
3 shkaktojnë "pasoja të rënda" për personin e mbrojtur. Të  
4 akuzuarit kundërshtuan konstatimet e Trupit Gjykses lidhur me  
5 veprimin e fajshëm të kësaj forme të rëndë.

6 Paneli konstaton se të akuzuarit nuk kanë arritur të  
7 provojnë se Trupi Gjykses gaboi që u mbështet në dëshminë e  
8 dëshmitarit të ZPS-së, W04842. Paneli konstaton më tej se z.  
9 Gucati nuk ka arritur të provojë se pse përmendja nga Trupi  
10 Gjykses e "cenimit thelbësor" në vend të "pasojeve të rënda"  
11 në pjesën e dispozitave ligjore përkatëse të aktgjykimit  
12 përbën gabim. Në fund, Trupi Gjykses i përmendi shprehimisht  
13 pasojat e rënda në konstatimet e tij lidhur me nenin 392,  
14 paragrafi 3, të Kodit Penal të Kosovës.

15 Z. Gucati gjithashtu kundërshtoi konstatimin e Trupit  
16 Gjykses në lidhje me dëshmitarët e rrezikuar. Për arsyet e  
17 shtjelluara në aktgjykimin e apelit, Paneli i Apelit konstatoi  
18 se Trupi Gjykses nuk gaboi që konstatoi që u shkaktuan pasoja  
19 të rënda për dëshmitarët që u zhvendosën me banim dhe që ishin  
20 objekt i planifikimit urgjent për shkak të rrezikut.  
21 Sidoqoftë, Paneli konstaton se ky konstatim vlen vetëm për dy  
22 dëshmitarë që u zhvendosën.

23 Tani do t'i kthehem personit të identifikuar në versionin  
24 konfidencial të aktgjykimit të Trupit Gjykses. E kam fjalën  
25 për personin i cili e kishte bërë publik bashkëpunimin e tij

1 me prokurorët që po kryenin hetime për veprat penale të cilat  
2 pretendohet se u kryen nga anëtarë të UÇK-së. Paneli i Apelit  
3 gjykon se konstatimet në lidhje me "frikën dhe shqetësimin e  
4 këtij personi shkaktuar nga përmendja publikisht e emrit të  
5 tij si dëshmitar" nuk bazohen në provat e disponueshme në këtë  
6 çështje gjyqësore. Trupi Gjygues nuk dha asnjë shpjegim në  
7 mbështetje të konstatimit të tij dhe as nuk shpjegoi më tej  
8 nëse ishte i mendimit që ankesa lidhur me publikimin e  
9 dokumenteve të nxjerra përbënte pasojë të rëndë.

10 Për këtë arsye, Paneli i Apelit pajtohet me z. Gucati se  
11 Trupi Gjygues gaboi sa i takon këtij konstatimi konkret dhe,  
12 rrjedhimisht, pranon Arsyen 11 të apelit të z. Gucati. Ndikimi  
13 i këtij konstatimi mbi dënimin do të diskutohet pas pak.

14 Në përfundim, për këtë pikë, Paneli i Apelit pranon  
15 Arsyen 11 të apelit të z. Gucati dhe Paneli rrëzon të gjitha  
16 kundërshtimet e tjera ndaj konstatimeve të Trupit Gjygues në  
17 lidhje me Pikën 6.

18 Tani Paneli do të trajtojë Pikën 3. Pika 3 përkon me  
19 veprën penale të frikësimit gjatë procedurës penale, e  
20 ndëshkueshme sipas nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës. Paneli  
21 do të fillojë me kundërshtimet e të akuzuarve ndaj veprimit të  
22 fajshëm të kësaj vepre penale.

23 Paneli i Apelit paraprakisht gjykon se është e qartë që  
24 Trupi Gjygues konstatoi se të akuzuarit ishin fajtorë sipas  
25 alternativës së parë të nenit 387; konkretisht, se kishin

1 përdorur kërcënime të rënda për të nxitur dikë që "të  
2 përmbahet nga dhënia e deklaratës".

3 Paneli do të trajtojë së pari argumentin e z. Gucati se  
4 Trupi Gjykses gaboi që konstatoi se pjesa e fundit e nenit 387  
5 të Kodit Penal të Kosovës në të cilin thuhet "kur informacione  
6 të tilla ndërlidhen me pengimin e procedurës penale" cilëson  
7 vetëm alternativën e tretë të nenit 378; domethënë, personin  
8 që nuk i jep "informacione të vërteta organeve policore,  
9 prokurorit apo gjykatësit" dhe jo alternativën e parë. Për  
10 arsyet që shpjegohen në aktgjykimin e apelit, Paneli i Apelit  
11 është i mendimit se formulimi "pengim i procedurës penale" nuk  
12 ka lidhje me alternativën e parë të nenit 387 dhe,  
13 rrjedhimisht, Trupi Gjykses nuk gaboi që nuk konstatoi se të  
14 akuzuarit përdorën kërcënime të rënda në lidhje me pengimin e  
15 procedurës penale.

16 Lidhur me përkufizimin e kërcënimit të rëndë, Paneli në  
17 kontekst të nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës, gjykon se  
18 synimi i ligjvënësve ishte që termi të përfshinte çfarëdo  
19 kërcënimi të rëndë për veprim të dëmshëm dhe jo vetëm  
20 kërcënimin për përdorimin e forcës.

21 Gjithashtu Paneli gjykon se, lidhur me argumentin e z.  
22 Gucati se "kërcënimi" nënkupton se një veprim i dëmshëm do të  
23 kryhet në të ardhmen, Trupi Gjykses, faktikisht, formuloi  
24 konstatime se persona do të pësojnë dëm si pasojë e veprimeve  
25 të të akuzuarve.

1 Lidhur me argumentin e z. Gucati se Trupi Gjykues gaboi  
2 që konstatoi se neni 387 i Kodit Penal të Kosovës nuk kërkon  
3 provë se "kërcënimi i rëndë", faktikisht, e nxiti një person  
4 që të mos bënte deklaratë, Paneli gjykon, për arsyet e  
5 përfshira në aktgjykimin e apelit, se interpretimi i Trupit  
6 Gjykues përputhet me formulimin e dispozitës dhe me qëllimin e  
7 saj.

8 Sa i takon argumentit të z. Haradinaj se deklaratat e tij  
9 nuk ishin kërcënime të hapura ose të nënkuptuara, Paneli  
10 gjykon se për arsyet e parashtruara në aktgjykimin e apelit,  
11 z. Haradinaj nuk arrin të provojë se asnjë gjykues i arsyeshëm  
12 faktesh nuk do të kishte arritur në përfundimin e Trupit  
13 Gjykues se veprimet dhe deklaratat e të akuzuarit përbënin  
14 kërcënim të rëndë.

15 Paneli do të trajtojë argumentet e z. Gucati lidhur me  
16 mbështetjen prej Trupit Gjykues në dëshminë e hetueses së ZPS-  
17 së, Dëshmitarja W04841, në lidhje me Pikën 3. Paneli rikujton  
18 konstatimin e vet të mëhershëm se Trupi Gjykues nuk gaboi në  
19 lidhje me mosnxjerrjen e Paketave. Gjithashtu, Paneli gjykon  
20 se fakti që i akuzuari identifikoi publikisht vetëm gjashtë  
21 persona nuk e zvogëlon kuadrin e nxjerrjes së informacionit  
22 dhe as ndikon në konstatimin se është vërtetuar veprimi i  
23 fajshëm i veprës penale.

24 Lidhur me kundërshtimet e z. Haradinajt ndaj  
25 metodologjisë së hetueses së ZPS-së, Dëshmitarja W04841,

1 Paneli, bazuar në arsyet e shtjelluara në aktgjykimin e  
2 apelit, nuk e gjykon të gabuar vlerësimin që bëri Trupi  
3 Gjykues analizës së saj të listës së dëshmitarëve.

4 Bazuar në sa më sipër, Paneli i Apelit konstaton se të  
5 akuzuarit nuk kanë arritur të provojnë ndonjë gabim në  
6 vlerësimin e Trupit Gjykues të veprimit të fajshëm të veprës  
7 penale të Pikës 3.

8 Më tej Paneli do të trajtojë kundërshtimet e z. Gucati  
9 ndaj konstatimeve të Trupit Gjykues në lidhje me synimin  
10 kriminal sipas nenit 387 të Kodit Penal të Kosovës. Së pari,  
11 Paneli gjykon se konstatimet e z. Gucati dhe z. Haradinaj  
12 kishin synimin e drejtpërdrejtë të përdornin kërcënimin e  
13 rëndë për t'i bërë dëshmitarët dhe dëshmitarët e mundshëm të  
14 mos jepnin dëshmi para Dhomat e Specializuara ose ZPS-së janë  
15 të arsyeshme.

16 Lidhur me argumentin e z. Gucati se një konstatim mbi  
17 synimin kriminal ishte i nevojshëm për sa i takon vërtetësisë  
18 së informacionit të dhënë nga dëshmitarët sipas nenit 387,  
19 Paneli rikujton se mosdhënia e "informacionit të vërtetë"  
20 është vetëm pjesë e një prej tre alternativave në nenin 387  
21 dhe, çka është e rëndësishme, të akuzuarit nuk u shpallën  
22 fajtorë mbi bazën e saj. Rrjedhimisht, Trupi Gjykues nuk ka  
23 gabuar.

24 Bazuar në faktin se synimi i drejtpërdrejtë u vërtetua,  
25 Paneli i Apelit konstaton se argumentet e z. Gucati se synimi

1 eventual nuk është i mjaftueshëm për shpallje fajësie sipas  
2 nenit 387 janë hipotetike dhe nuk do të ndikonin në  
3 konstatimet.

4 Së fundi, Paneli i Apelit konstaton se Trupi Gjykses e  
5 trajtoi konkretisht interpretimin alternativ prej z. Haradinaj  
6 të provave lidhur me synimin e drejtpërdrejtë dhe për  
7 rrjedhojë nuk ka gabuar.

8 Bazuar mbi këtë, Paneli konstaton se z. Gucati dhe z.  
9 Haradinaj nuk arritën të provonin gabim në vlerësimin e Trupit  
10 Gjykses të synimit kriminal të veprës penale të frikësimit  
11 gjatë procedurës penale.

12 Në përfundim, Paneli i Apelit rrëzon kundërshtimet e  
13 Mbrojtjes ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me  
14 Pikën 3 dhe në vijim do të trajtoj Pikën 1.

15 Pika 1 e aktakuzës ka të bëjë me veprën penale të  
16 pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare  
17 përmes kërcënimit të rëndë e ndëshkueshme sipas nenit 401,  
18 paragrafët 1 dhe 5, të Kodit penal të Kosovës. Paneli do të  
19 fillojë me kundërshtimet e të akuzuarve në lidhje me veprimin  
20 e fajshëm të veprës penale.

21 Lidhur me përkufizimin e "kërcënimit të rëndë", Paneli  
22 gjykon se synimi i ligjvënësve ishte që termi të përfshinte  
23 çfarëdo kërcënimi të rëndë për veprim të dëmshëm dhe jo vetëm  
24 kërcënim për përdorimin e forcës.

25 Lidhur me drejtimin e "kërcënimit të rëndë", Paneli, me



1 përjashtim të mospajtimit të Gjykatësit Ambos, pajtohet me  
2 konstatimin e Trupit Gjykues se në formulimin e kësaj  
3 dispozite nuk kërkohet që kërcënimi i rëndë të drejtohet  
4 konkretisht kundër personit zyrtar. Paneli i Apelit gjykon  
5 gjithashtu se interpretimi i Trupit Gjykues është në përputhje  
6 me qëllimin e dispozitës për këtë vepër penale, që nuk është  
7 të mbrojtje persona zyrtarë si të tillë, por t'i mbrojtje ata në  
8 kryerjen e detyrave të tyre zyrtare. Për këtë arsye Paneli, me  
9 përjashtim të mospajtimit të Gjykatësit Ambos, nuk e gjykon të  
10 gabuar konstatimin se vepra penale e nenit 401, paragrafi 1,  
11 të Kodit Penal të Kosovës është vërtetuar në këtë çështje, ku  
12 kërcënimi i rëndë drejtohet kundër atyre që dhanë dëshmi për  
13 Dhomat e Specializuara apo ZPS-së ose që me gjasë do të  
14 jepnin.

15 Lidhur me argumentin e z. Gucati se përdorimi i forcës  
16 ose kërcënimit të rëndë duhet të jetë i njëkohshëm me kryerjen  
17 e detyrave zyrtare, Paneli gjykon se një interpretim i tillë  
18 nuk do të ishte në përputhjen me mbrojtjen që ky nen synon të  
19 ofrojë për kryerjen në siguri të detyrave zyrtare dhe nuk  
20 bazohet në tekstin e dispozitës.

21 Bazuar në sa më sipër, shumica e Panelit konstaton se të  
22 akuzuarit nuk kanë arritur të provojnë gabim në vlerësimin  
23 prej Trupit Gjykues të veprimit të fajshëm të veprës penale të  
24 Pikës 1.

25 Paneli do të trajtojë më tej kundërshtimet e z. Gucati

1 ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses në lidhje me synimin  
2 kriminal të kësaj veprë penale. Paneli i Apelit gjykon se  
3 ndonëse Trupi Gjykses nuk përsëriti fjalë për fjalë standardin  
4 ligjor në konstatimin e vet për synimin e të akuzuarve, ai  
5 bëri konstatimet përkatëse në gjetiu në aktgjykim;  
6 gjegjësisht, se të akuzuarit synonin përdorimin e kërcënimit  
7 të rëndë kundër dëshmitarëve apo dëshmitarëve të mundshëm si  
8 mjet për pengimin e zyrtarëve të Dhomat e Specializuara apo të  
9 ZPS-së në kryerjen e punës së tyre. Bazuar në këtë, Paneli  
10 gjykon se z. Gucati nuk ka arritur të provojë gabim në  
11 vlerësimin prej Trupit Gjykses të synimit kriminal të veprës  
12 penale të Pikës 1.

13 Në përfundim, shumica e Trupit Gjykses rrëzon  
14 kundërshtimet e Mbrojtjes ndaj konstatimeve të Trupit Gjykses  
15 në lidhje me Pikën 1.

16 Paneli tani do të trajtojë arsyet e apelit të z. Gucati  
17 dhe Z. Haradinaj për sa i takon raportit të bashkimit të  
18 veprave midis Pikave 1 dhe 2; konkretisht, veprat penale të  
19 pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare  
20 përmes forcës ose kërcënimit të rëndë dhe pengimit të  
21 personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare përmes  
22 veprimit të përbashkët të një grupi. Trupi Gjykses zbatoi  
23 standardit e fajësisë së shumëfishtë, i cili është zbatuar  
24 prej tribunaleve ndërkombëtar *ad hoc*, që mundëson fajësime  
25 penale në bazë të dispozitave ligjore të ndryshme, në qoftë se

1    secila dispozitë ligjore në fjalë përmban një element  
2    materialisht të dallueshëm që nuk e përmban tjetra. Bazuar në  
3    këtë standard, Trupi Gjykses i shpalli fajtorë të akuzuarit si  
4    për Pikën 1, ashtu dhe për Pikën 2.

5           Sidoqoftë, për arsyet e shpjeguara në aktgjykimin e  
6    apelit, Paneli i Apelit gjykon se standardi i fajësisë së  
7    shumëfishtë i të drejtës penale ndërkombëtare zbatuar nga  
8    Trupi Gjykses nuk është i përshtatshëm në rrethanat konkrete  
9    të kësaj çështjeje. Paneli vendosi të mbështetej në konceptin  
10   e së drejtës civile të bashkimit të veprave. Në këtë drejtim  
11   Paneli, ndër të tjera, gjykoi se ndryshimi në dënimet minimale  
12   midis dy dispozitave mund të shpjegohet prej faktit se  
13   paragrafi 1 i nenit 401 të Kodit Penal të Kosovës kërkon  
14   veprime individuale konkrete të pengimit, kurse në kontekstin  
15   e paragrafit të dytë, përgjithësisht nuk do të ishte e  
16   mundshme të vërtetoheshin veprime individuale konkrete të  
17   pengimit nga të akuzuarit.

18           Mbi këtë bazë, Paneli gjykon se raporti midis këtyre dy  
19   dispozitave ngërthehet më së miri prej rregullës së  
20   subsidiaritetit dhe se në këtë çështje ku veprimet individuale  
21   të të akuzuarve janë specifikuar dhe të akuzuarit janë  
22   shpallur fajtorë në bazë të nenit 401, paragrafi 1, të Kodit,  
23   një verdikt i mëtejshëm fajësie në bazë të nenit 401,  
24   paragrafi 2, nuk është as i përlligjur e as i nevojshëm.

25           Si rrjedhojë, Paneli miraton Arsyen 16 të z. Gucati dhe

1 pjesërisht Arsyen 3 të z. Haradinaj; vendos se të akuzuarit  
2 mund të shpallen fajtorë vetëm për Pikën 1 të aktakuzës dhe i  
3 shpall të pafajshëm për Pikën 2 të aktakuzës. Ndikimi i këtij  
4 konstatimi, nëse do të ketë, mbi dënimin e të akuzuarve do të  
5 trajtohet pas pak.

6 Bazuar në këtë konstatim, Paneli konstaton se është e  
7 panevojshme të trajtohen argumentet e z. Gucati lidhur me  
8 Pikën 2 dhe pretendimet e tij për gabime të Trupit Gjykues në  
9 lidhje me veprimin e fajshëm dhe synimin kriminal sipas nenit  
10 401, paragrafi 2, të Kodit penal të Kosovës.

11 Paneli tani do të trajtojë kundërshtimet e z. Gucati dhe  
12 z. Haradinaj lidhur me argumentet mbrojtëse dhe arsyet për  
13 përjashtimin e përgjegjësisë për sjelljen e tyre.

14 Në gjykim, të akuzuarit paraqitën disa argumente  
15 mbrojtëse dhe arsye për përjashtimin e përgjegjësisë për  
16 sjelljen e tyre. Sidoqoftë, Trupi Gjykues konstatoi se  
17 përgjegjësia penale e të akuzuarve nuk mund të përjashtohet  
18 mbi bazën e argumenteve mbrojtëse apo arsye për përjashtimin e  
19 përgjegjësisë të paraqitura prej tyre.

20 Në apelet e tyre, të akuzuarit ngritën kundërshtime ndaj  
21 konstatimeve të Trupit Gjykues ku nuk u pranuan argumentet e  
22 paraqitura prej tyre në lidhje me interesin publik,  
23 sinjalizimin, shtytje për kryerje të veprës penale, nevojën  
24 ekstreme dhe vepra të rëndësisë së vogël.

25 Për arsyet e shtjelluara në aktgjykimin e apelit, Paneli

1 rrëzon të gjitha arsyet e apeleve të të akuzuarve në lidhje me  
2 këto aspekte. Paneli nuk do të japë përmbledhje të detajuar të  
3 secilit prej konstatimeve të veta. Megjithatë, Paneli do të  
4 trajtojë aspekte konkrete me interes në këtë përmbledhje.

5 Së pari, lidhur me mbrojtjen e interesit publik, Paneli  
6 pranon se disa nga argumentet e Gucatit kanë të bëjnë me  
7 standardin dhe detyrimin e vërtetimit për arsye që  
8 përjashtojnë përgjegjësitë penale, standard që kërkon vëmendje  
9 të veçantë.

10 Duke iu referuar një numri burimesh, Paneli sqaron se ka  
11 ndryshim midis detyrimit të ZPS-së për vërtetimin e fajësisë  
12 së të akuzuarit jashtë dyshimit të arsyeshëm "detyrimi për të  
13 bindur" dhe përgjegjësisë së Mbrojtjes për paraqitjen e  
14 provave në mbështetje të arsyeve që përjashtojnë përgjegjësinë  
15 penale "detyrimi i paraqitjes së provave apo detyrimi i  
16 provave".

17 Së dyti, lidhur me pretendimin e Mbrojtjes të shtytjes  
18 për kryerje të veprës penale nga ZPS-ja, Paneli është i  
19 vetëdijshëm se palët kanë paraqitur parashtrime të gjata mbi  
20 këtë temë që është debatuar gjerësisht si në fazën e gjyqimit  
21 po ashtu edhe në atë të apelit.

22 Paneli vëren se Trupi Gjykses me të drejtë konstatoi se  
23 "përveç nëse pretendimet e të akuzuarve të jenë tërësisht të  
24 pagjasa, i takon Prokurorisë të provojë se nuk ka pasur  
25 shtytje për kryerje të veprës penale", si dhe identifikoi

1 saktësisht detyrimin e Gjykatës që "të shqyrtojë faktet e  
2 çështjes dhe të ndër marrë hapat e nevojshëm për të zbuluar  
3 nëse ka pasur shtytje për kryerjen e veprës penale". Në pajtim  
4 me jurisprudencën e Gjykatës Evropiane për Të Drejtat e  
5 Njeriut, Trupi Gjykues nuk gaboi që u referua kritereve të  
6 provave *prima facie*.

7 Paneli i Apelit në vijim konstaton se Mbrojtja  
8 keqinterpretonte standardin e zbatueshëm nga jurisprudenca e  
9 Gjykatës Evropiane për Të Drejtat e Njeriut kur argumenton se  
10 "se standardi jotërësisht i pagjasë" është kaq i ulët saqë  
11 përjashton çdo kriter për paraqitje provash prej Mbrojtjes.

12 Për këtë arsye të detajuara e të shtjelluara në  
13 aktgjykimin e apelit, Paneli i Apelit konstaton se z. Gucati  
14 dhe z. Haradinaj nuk kanë arritur të provojnë se Trupi Gjykues  
15 gaboi që konstatoi se pretendimi i shtytjes për kryerje të  
16 veprës penale i ngritur prej tyre ishte tërësisht i pagjasë  
17 dhe i pabazuar.

18 Tani Paneli do të trajtojë kundërshtimet e z. Gucati dhe  
19 z. Haradinaj në lidhje me dënimin.

20 Së pari, Paneli do të trajtojë kundërshtimet e z. Gucati  
21 ndaj vlerësimit prej Trupit Gjykues të peshës së krimit.  
22 Sikurse është shtjelluar më tej në aktgjykimin e apelit,  
23 Paneli gjykon se Trupi Gjykues nuk gaboi në konstatimet e veta  
24 lidhur me peshën dhe shkallën e veprave penale të kryera prej  
25 të akuzuarve të përfshirë në aktakuzë.

1 Paneli i referohet argumentit të z. Gucati se Trupi  
2 Gjykues gaboi që nuk e pasqyroi siç duhet në përcaktimin e  
3 dënimit rolin konkret të Gucatit krahasuar me atë të z.  
4 Haradinaj sipas Pikës 3. Paneli gjykon se Trupi Gjykues  
5 vlerësoi me kujdes provat dhe të gjithë faktorët përkatës për  
6 përcaktimin e dënimit, si dhe rolin e z. Gucati në veprat  
7 penale në krahasim me rolin e z. Haradinaj. Rrjedhimisht,  
8 Paneli konstaton se z. Gucati nuk ka arritur të provojë gabim  
9 në përcaktimin e dënimit të tij nga Trupi Gjykues në lidhje me  
10 Pikën 3.

11 Sikurse arsyetohet më tej në aktgjykimin e apelit, Paneli  
12 gjithashtu rrëzoi kundërshtimet e z. Haradinaj ndaj  
13 konstatimeve të Trupit Gjykues në përcaktimin e dënimit në  
14 lidhje me atmosferën e frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë  
15 dhe ushtrimin prej z. Haradinaj të së drejtës së lirisë së  
16 shprehjes.

17 Paneli gjykon se, sikurse u diskutua gjithashtu gjatë  
18 seancës së apelit, përputhshmëria në dënim është e  
19 rëndësishme, por duhet mundësuar ushtrimi i kompetencës  
20 diskrecionale të Trupit Gjykues lidhur me faktet e çështjes  
21 konkrete. Sikurse shtjellohet më tej në aktgjykimin e apelit,  
22 Paneli i mori parasysh çështjet gjyqësore përkatëse në Kosovë  
23 dhe çështje përkatëse të gjykatave dhe tribunalëve  
24 ndërkombëtarë të paraqitura nga palët.

25 Paneli është i vetëdijshtë për ndryshimet midis dënimeve

1 të dhëna nga gjykata dhe tribunalë penal ndërkombëtarë dhe  
2 dënimeve në këtë çështje. Sidoqoftë, Paneli i Apelit nuk mund  
3 të shpërfillë faktet konkrete të kësaj çështjeje, të marra në  
4 kontekstin e kornizës ligjore në fuqi në Kosovë dhe  
5 shkallëzimin e dënimeve në Kodin Penal të Kosovës. Duke marrë  
6 parasysh peshën e veprave penale të të akuzuarit, Paneli i  
7 Apelit konstaton se Trupi Gjykses nuk gaboi në përcaktimin e  
8 dënimeve e të të akuzuarve mbi bazën e fajësisë së shpallur.

9 Paneli gjithashtu konstatoi se gabimi i Trupit Gjykses i  
10 identifikuar në Pikën 6 në lidhje me formën e rëndë të veprës  
11 penale nuk pati ndikim mbi dënimin.

12 Sidoqoftë, Paneli i Apelit rikujton konstatimet e veta të  
13 mëhershme në lidhje me Pikat 1 dhe 2, në të cilat prapësoi  
14 verdiktin e fajësisë së z. Gucati dhe z. Haradinaj për Pikën  
15 2. Si pasojë, Paneli gjykon se dënimet e njehsuara të dhëna  
16 nga Trupi Gjykses duhet të ulen. Për arsyet e shtjelluara në  
17 aktgjykimin e apelit, Paneli me përjashtim të mospajtimit të  
18 Gjykatësit Ambos, vendos që dënimi për z. Gucati dhe z.  
19 Haradinaj të ulet për secilin me tre muaj në një dënim të  
20 njehsuar me katër vjet e tre muaj burgim.

21 Gjykatësi Ambos pajtohet me arsyetimet dhe konstatimet e  
22 Panelit të Apelit në lidhje me Pikat 3, 5 dhe 6. Gjithashtu  
23 pajtohet me arsyetimin e Panelit të Apelit lidhur me raportin  
24 e bashkimit të veprave midis paragrafit 1 dhe paragrafit 2 të  
25 Kodit Penal të Kosovës, Pikat 1 dhe 2. Gjykatësi Ambos,



1 gjithashtu, nuk pajtohet me shumicën në lidhje me  
2 interpretimin e veprimit të fajshëm sipas nenit 401, paragrafi  
3 1, të Kodit Penal të Kosovës. Rrjedhimisht, mbi këtë bazë ai  
4 do t'i kishte shpallur të pafajshëm të akuzuarit në lidhje me  
5 Pikën 1 të aktakuzës dhe do ta kishte ulur dënimin e dhënë  
6 kundër tyre në katër vjet.

7 Tani u kërkoj z. Gucati dhe z. Haradinaj të ngrihen në  
8 këmbë ndërkohë që unë, në emër të Panelit, do të lexoj tekstin  
9 e plotë të vendimit të aktgjykimit të apelit.

10 Mund të rrini në këmbë, ju lutem.

11 Paneli i Gjykatës së Apelit në bazë të nenit 46 të Ligjit  
12 dhe rregullave 182 dhe 183 të Rregullores:

13 Pranon Arsyen 11, 16 dhe pjesën përkatëse të Arsyes 20 të  
14 apelit të z. Gucati dhe pjesën përkatëse të Arsyes 3 dhe  
15 pjesën përkatëse të Arsyes 24 të apelit të z. Haradinaj;

16 Rrëzon apelet e z. Gucati dhe Haradinaj në të gjithë  
17 pikat e tyre;

18 Prapëson verdiktin e fajësisë së z. Gucati dhe z.  
19 Haradinaj për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e  
20 detyrave zyrtare përmes pjesëmarrësve në veprimin e përbashkët  
21 të një grupi sipas Pikës 2 të aktakuzës;

22 Lë në fuqi verdiktin e fajësisë së z. Gucati dhe z.  
23 Haradinaj për frikësim gjatë procedurës penale sipas Pikës 3  
24 të aktakuzës, shkelje të fshehtësisë së procedurës përmes  
25 zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të

1 nxjerrë në procedurë zyrtare sipas Pikës 5 të aktakuzës dhe  
2 shkelje të fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të  
3 paautorizuar të identiteteve dhe të dhënave personale të  
4 dëshmitarëve të mbrojtur sipas Pikës 6 të aktakuzës;

5 Dhe gjithashtu lë në fuqi, me përjashtim të mospajtimit  
6 të Gjykatësit Ambos, verdiktin e fajësisë së z. Gucati dhe z.  
7 Haradinaj për pengimin e personave zyrtarë në kryerjen e  
8 detyrave zyrtare përmes kërcënimit të rëndë sipas Pikës 1 të  
9 aktakuzës;

10 Anulon vendimin e njehsuar prej katër vjet e gjysëm  
11 burgim për z. Gucati dhe z. Haradinaj dhe cakton, me  
12 përjashtim të mospajtimit të Gjykatësit Ambos, një dënim të  
13 njehsuar me katër vjet e tre muaj burgim për z. Gucati duke  
14 llogaritur dhe kohën e paraburgimit dhe një dënim të njehsuar  
15 me katër vjet e tre muaj për z. Haradinaj, duke llogaritur  
16 kohën e kaluar në paraburgim;

17 Lë në fuqi dënimin shtesë për z. Gucati dhe z. Haradinaj  
18 me një gjobë prej 100 eurosh;

19 Vendos që ky aktgjykim të zbatohet me efekt të  
20 menjëhershëm në bazë të rregullit 185, paragrafi 1, të  
21 Rregullores;

22 Dhe urdhëron që, në pajtim me nenin 50, paragrafi 1, të  
23 Ligjit dhe rregullin 166, paragrafi 3, të Rregullores, z.  
24 Gucati dhe z. Haradinaj të mbeten në paraburgim të Dhomave të  
25 Specializuara deri në finalizimin e masave për transferimin e

1 tyre në shtetin ku do të vuajnë dënimin.

2 Z. Gucati dhe z. Haradinaj, mund të uleni.

3 Zyra Administrative tani do të shpërndajë aktgjykimin e

4 apelit në formë elektronike dhe do t'u japë kopje të

5 legalizuara të versionit në anglishte z. Gucati dhe z.

6 Haradinaj. Versioni në shqip do t'ju jepet sapo të jetë gati.

7 E pashë që ua dhanë kopjet e legalizuara z. Haradinaj dhe

8 z. Gucati.

9 Dhe këtu përfundon procedura e apelit.

10 Seanca mbyllet.

11 --- Seanca mbyllet në orën 14.46

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25